

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË
P No 63/09
29 dhjetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË, Gjykatësja e EULEX-it Caroline Charpentier si Gjykatëse e shqyrtimit kryesor, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Zane Ratniece si proçesmbajtëse, në çështjen penale kundër:

G.M. dhe **S. M.**, të dy të akuzuar, sipas Propozim Akuzës PP No. 1400/09, të datës 24 gusht 2009, dhe të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës Komunale në Mitrovicë më 31 gusht 2009, me veprat penale të Dëmtimit të pasurisë së luajtshme, nën nenin 260 paragrafi (1) të Kodit Penal të Kosovës, dhe Kanosjes ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit Penal të Kosovës;

Pas mbajtjes së seancave dëgjimore publike të shqyrtimit kryesor më 28 dhe 29 dhjetor 2010, të gjitha në prani të të akuzuarëve **G. M.** dhe **S. M.**, Prokurorit Publik të EULEX-it Petr Klement, Palëve të dëmtuara **A. D.**, **A. J.** dhe **M. B.** (përpos seancës së datës 28 dhjetor 2010 kur **M. B.** nuk ka qenë i pranishëm), në pajtim me nenin 473 paragrafi (2) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës shpalli publikisht dhe në prani të të dy të akuzuarve, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe Palëve të dëmtuara (përpos **M. B.** i cili zgjodhi të largohet nga njëra pjesë e seancës dëgjimore të datës 29 dhjetor 2010), si në vijim:

AKTGJYKIM

I.

G. M., i biri i... , i lindur më... , ne fshatin..., Shqiptar Kosovar, me banim në rrugën..., fshati ..., Komuna e ..., ka të kryer shkollën e lartë, vozitës, të ardhurat mesatare mujore ...Euro, i martuar, ka ... fëmijë;

SHPALLET I PAFAJSHËM

- A)** **sepse** nuk është vërtetuar se **G. M.** më 08 maj 2008 ka dëmtuar apo asgjësuar apo e ka bërë të papërdorshme pronën e luajtshme të një personi tjetër në një dyqan që gjendet në tregun në rrugën ‘Mbretëresha Teuta’, në Mitrovicë;

PRANDAJ, në pajtim me nenin 390 pika 3) e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, **G. M.**

LIROHET

Nga akuza për kryerje të veprës penale të Dëmtimit të pronës së luajtshme, nën nenin 260 paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës;

SHPALLET FAJTOR

- B)** sepse më 08 maj 2008, rreth 14:00h, në një dyqan që gjendet në tregun në rrugën 'Mbretëresha Teuta', në Mitrovicë, **G. M.** duke mbajtur tërë kohën një teslicë në dorën e djathtë ka kërcënuar rëndë gojarisht se do të lëndojë policët **A. D.** dhe **A. J.**, të cilët kanë qenë në detyrë, duke u thënë policëve se do t'ua presë kokën; dhe më vonë, duke qenë i prangosur, duke i thënë policit **A. J.** se ai (**A. J.**) do të shohë më vonë se kush është **G. M.**, kur **A. J.** të veshte me rroba civile; **G. M.** i ka bërë këto kërcënime me qëllim që t'u shkaktojë shqetësim policëve **A. D.** dhe **A.J.**;

Duke bërë këtë, i akuzuari **G. M.** ka kryer dhe mban përgjegjësi penale për veprën penale të

Kanosjes ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

I akuzuari **G. M.**

DËNOHET

Me tre (3) muaj burgim për veprën penale të Kanosjes ndaj personit zyrtar.

Në pajtim me nenin 38 paragrafi (3) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dënimi me (3) muaj burgim zëvendësohet me gjobë prej 80 (tetëdhjetë) Euro (EUR). **G. M.** duhet te paguajë gjobën prej 80 (tetëdhjetë) Eurove (EUR) brenda tre (3) muajsh nga data që ky Aktgjykim hyn në fuqi.

Nëse gjoba nuk mund të inkasohet përmes detyrimit, Trupi gjykues mund të zëvendësojë gjobën me punë me dobi të përgjithshme me pëlqimin e **G. M.** Nëse nuk jepet pëlqimi, Trupi gjykues do të japë urdhër për një ditë burgim për çdo 15 (pesëmbëdhjetë) Euro (EUR) gjobë.

II.

I akuzuari **S. M.**, i biri i ...dhe, i lindur më ..., në fshatin ..., Shqiptar i Kosovës, me banim në rrugën ..., ..., Komuna e ..., i diplomuar në fakultetin juridik, i papunë, i martuar, ka ... fëmijë;

SHPALLET I PAFAJSHËM

- A)** **sepse** nuk është vërtetuar se **S. M.** më 08 maj 2008 ka dëmtuar apo asgjësuar apo e ka bërë të papërdorshme pronën e luajtshme të një personi tjetër në një dyqan që gjendet në tregun në rrugën ‘Mbretëresha Teuta’, në Mitrovicë;

PRANDAJ, në pajtim me nenin 390 pika 3) e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, **S. M.**

LIROHET

Nga akuza për kryerje të veprës penale të Dëmtimit të pronës së luajtshme, nën nenin 260 paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës;

SHAPLLET I PAFAJSHËM

- B)** **sepse** nuk është vërtetuar se më 08 maj 2008, në një dyqan në tregun në rrugën ‘Mbretëresha Teuta’, në Mitrovicë, **S. M.** ka kërcënuar rëndë se do të lëndojë, me qëllim t’i frikësojë apo t’u shkaktojë shqetësim, policët **A. D.** dhe **A. J.**, të cilët ishin në kryerje të detyrave të tyre zyrtare, apo çdo polic tjetër;

PRANDAJ, në pajtim me nenin 390 pika 3) e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, **S. M.**

LIROHET

Nga akuza për kryerje të veprës penale të Kanosjes ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Meqë Trupi gjykues e shpall të akuzuarin **G. M.** fajtor për Kansoje ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, **G. M.**, në pajtim me nenin 102 paragrafi (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, do të kompenzojë shpenzimet e procedurës penale lidhur me veprën penale të Kanosjes ndaj personit zyrtar, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Sa i përket shumës së shpenzimeve Trupi

gjkues do të lëshojë një aktvendim të veçantë atëherë kur të sigurohen të dhënat e tilla sipas nenit 100 paragrafi (2) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

ARSYETIM

A. Kompetenca e Gjykatës

Më 31 gusht 2009, Prokurori Publik i EULEX-it Maria Bamieh nga ngritur Propozim Akuzën PP Nr. 1400/09 pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë. Edhe pse Propozim Akuza PP Nr. 1400/09 i ishte adresuar Gjykatës Komunale në Mitrovicë, në Propozim Akuzë është propozuar që *'shqyrtimi kryesor për këtë lëndë të planifikohet dhe të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë'*.¹ Trupi gjykues ka marrë parasysh akuzat e paraqitura në Propozim Akuzën kundër **S. M.** dhe **S. M.**, në veçanti veprat e pretenduara penale:

- Dëmtim i pasurisë së luajtshme, nën nenin 260 paragrafi (1) të Kodit Penal të Kosovës; dhe
- Kanosje ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit Penal të Kosovës.

Duke i marrë parasysh akuzat e përmendura, lënda kishte rënë në nivelin e gjykatës komunale meqë sipas nenit 21 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës gjykatat komunale janë kompetente të dëgjojnë çështjet penale që përfshijnë akuzat e dënueshme me gjobë apo burgim deri në pesë vjet. Akuza për dëmtim të pronës së luajtshme, nën nenin 260 paragrafi (1) të Kodit Penal të Kosovës lejon caktimin e ndëshkimit me gjobë apo burgim deri në gjashtë muaj, dhe akuza për kanosje ndaj personit zyrtar, sipas nenit 161 paragrafi (4) të Kodit Penal të Kosovës lejon caktimin e denimit me burg prej tre muaj deri në tre vjet.

Për më shumë, në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, jurisdiksioni territorial i takon gjykatës brenda territorit të së cilës pretendohet se është kryer krimi. Propozim Akuza ka pretenduar se veprat penale janë kryer në pjesën jugore të Mitrovicë.

Prandaj, Gjykata Komunale e Mitrovicës ka pasur të dyja, edhe kompetencën lëndore edhe jurisdiksionin territorial të shqyrtojë çështjen.

Më 02 gusht 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it ushtroi të drejtën e saj për t'ia caktuar lëndën Gjykatësve të EULEX-it në pajtim me nenin 3.3 të 'Ligjit mbi Kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë'. Lënda i është caktuar Gjykatësve të EULEX-it duke marrë

¹ Propozim Akuza PP No. 1400/09 në gjuhën angleze

parasysh situatën e Gjykatës Komunale në Mitrovicë dhe të shmanget zbatimi i gabuar i ligjit.

B. Ligji i aplikueshëm

Propozim Akuza PP No. 1400/09 ka akuzuar **G. M.** dhe **S. M.** në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. E drejta materiale e aplikueshme në këtë rast është ajo që ka qenë në fuqi në kohën përkatëse, pra kur është kryer vepra penale. Propozim Akuza ka pretenduar se veprat penale janë kryer më 08 maj 2008. Në atë kohë Kodi ka qenë i titulluar Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Kodi është riemëruar si Kodi Penal i Kosovës duke hyrë në fuqi prej 06 janarit 2009, që është *pas* kryerjes së pretenduar të veprave penale. Prandaj, Trupi gjykues ka aplikuar Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

C. Përmbledhje e provave të parashtruara

Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët si në vijim:

- (1) **A. D.** – Palë e dëmtuar, 28 dhjetor 2010
- (2) **A. J.** – Palë e dëmtuar, 28 dhjetor 2010
- (3) **F. G.** – Dëshmitar, 28 dhjetor 2010
- (4) **F. R.** – Dëshmitar, 28 dhjetor 2010
- (5) **Xh.J.** – Dëshmitar, 28 dhjetor 2010
- (6) **M. B.** – Palë e dëmtuar, 29 dhjetor 2010

Dokumentet në vijim janë prezantuar me qëllim që të perdoren si prova nga Prokurori Publik i EULEX-it, dhe janë konsideruar si të lexuara bazuar në pajtimin e palëve:

- (7) Intervistë e **G. M.** para Shërbimit Policor të Kosovës, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (8) Intervistë e **S. M.** para Shërbimit Policor të Kosovës, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-(*pa numër*)
- (9) Intervistë e **M. B.** para Shërbimit Policor të Kosovës, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (10) Raport i policit **F. R.**, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (11) Raport i policëve **A. D.** dhe **A. J.**, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (12) Notë zyrtare, Njësia e Hetimeve, Stacioni Policor në Jug Mitrovicë, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-(*pa numër*)
- (13) Raport për hapje të lëndës, 20 nëntor 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (14) Akt përcjellës, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, 20 nëntor 2008 (numri i dosjes 2008/821/MRC/MM)
- (15) Raport, Njësia e Hetimeve, Stacioni i Policisë në Jug Mitrovicë, (*pa datë*) lënda numër 2008-BC-1014

- (16) Detaje të lëndës, Divizioni penal i UNMIK-ut, 25 nëntor 2008 (numri i dosjes 2008/821/MRC/MM)
- (17) Letër përcjellëse, Shërbimi i Policisë së Kosovës, 23 korrik 2008, numri i dosjes 2008-BC-1014
- (18) Akuzat penale, Njësia e Hetimeve, Stacioni Policor në Jug, 23 korrik 2008, numri i referencës 2008-BC-1014
- (19) Raport fillestar i incidentit, 08 maj 2008, lënda numër 2008-BC-1014
- (20) Marrëveshje, numër 184, 11 tetor 2004
- (21) Fotografi, 2008-BC-1014

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 28 dhjetor 2010, të akuzuarit **G. M.** dhe **S. M.** kanë dhënë dëshmitë e tyre dhe i kanë përgjigjur pyetjeve.

D. Vlerësimi i provave të prezantuara

1. Të gjeturat faktike

Sipas provave të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor, Trupi gjykues i ka konsideruar faket në vijim si të vërtetuara:

Më 08 maj 2008, në Mitrovicë policët **A. D.** dhe **A. J.** janë urdhëruar nga mbikëqyrësit e tyre të shkojnë në tregun në rrugën 'Mbretëresha Teuta', në Mitrovicë. **G. M.** dhe **S. M.** kanë qenë në dyqan, në treg, duke marrë tela dhe gjësende të tjera nga dyqani. Paraprakisht, **G. M.** i ishte thënë nga menaxheri i ndërmarrjes 'T', **M. B.**, se ai mund të marrë investimet e tij nga dyqani. Rreth orës 14:00 policët **A. D.** dhe **A. J.** arritën në dyqan dhe kërkuan nga **G. M.** dhe **S. M.** të ndalojnë marrjen e gjësendeve. **G. M.** ka refuzuar t'i bindet kërkesë së policëve dhe duke mbajtur një teslicë në dorën e djathtë gojarisht i është kërcënuar policëve **A. D.** dhe **A. J.**, poashtu duke thënë se do t'ua presë kokën. Duke mos u ndier të sigurtë për shkak të sjelljes së **G. M.**, policët kanë kërkuar ndihmë nga kolegët. Ndërkohë, duke qenë i prangosur, **G. M.** ka kërcënuar policin **A. J.** duke thënë se **A. J.** do të shohë se kush është **G. M.**, kur **A. J.** të gjendet në rroba civile. Në anën tjetër, **S. M.** ka qëndruar i qetë.

*2. Provat lidhur me dëmtimin e pronës së luajtshme nga **G. M.** dhe **S. M.***

S. M. në intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës, më 08 maj 2008, ka deklaruar se, më 08 maj 2008, xhaxhai i tij **G. M.** kishte kërkuar nga ai t'i ndihmojë të transportojë disa gjësende nga dyqani i **G. M.** në tregun në Mitrovicë. Në seancën e shqyrtimit kryesor më 28 dhjetor 2010 **S. M.** ka konfirmuar se **G. M.** ka kërkuar nga ai t'i ruajë disa gjësende në dyqan, meqë tregu po zhvendosej. Poashtu, **G. M.** kishte thënë se këto gjësende ishin pronë e tij.

Në **intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës**, më 08 maj 2008, **G. M.**, ka deklaruar se ai kishte bërë investime në dyqan dhe më 08 maj 2008 ai ka shkuar të marrë disa gjësende, pasi tregu po zhvendosej. **G. M.** ka konfirmuar se më 08 maj 2008 ai ka qenë duke larguar gjësendet në dyqan deri në momentin kur është ndaluar nga policët. Kjo është mbështetur nga **S. M.**

Si dëshmi për të drejtën e tij të marrë gjësendet nga dyqani, **G. M.** ka prezantuar **Marrëveshjen**, numër 184, të nënshkruar me ndërmarrjen 'T.' më 11 tetor 2004. Neni 4 i Marrëveshjes parasheh që *'palët kontraktuese pajtohen që nëse NP 'T.' privatizohet, atëherë qiramarrësi do të marrë orën e rrymës dhe atë të ujit, dhe dyert e dyqanit poashtu'*. Marrëveshja nuk është kontestuar apo kundërshtuar nga asnjëra palë.

Dëshmia e Palës së dëmtuar **M. B.**, ish-menaxher i ndërmarrjes 'T', i dëgjuar si dëshmitar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29 dhjetor 2010, ka mbështetur deklaratën e të akuzuarit **G. M.**. **M. B.** ka konfirmuar se është lidhur kontratë për shfrytëzim të hapësirës, ai poashtu ka konfirmuar se në Marrëveshje, numër 184, është nënshkrimi i tij. Në veçanti, **M. B.** ka pranuar se e kishte udhëzuar **G. M.** të vijë në dyqanin e tij për të marrë të gjitha që mundet përpara shkatërrimit të plotë të tregut. **M. B.** ka mohuar të ketë pësuar ndonjë dëm nga veprimi i ndërmarrë nga **G. M.** dhe **S. M.** në ditën kritike.

Nga provat e prezantuara Trupit gjykues, asgjë nuk ka vërtetuar se gjësendet e marra nga **G. M.** nuk kanë qenë pronë e tij. Veç kësaj, nuk ka pasur ndonjë listë të gjësendeve të marra në mënyrë të kundërligjshme. Për më tepër, **M. B.** ka thënë se është e mundur që njerëz të tjerë kanë marrë ndonjë pronë të luajtshme nga dyqani i **G. M.**, përpara arritjes së tij aty, meqë tregu ishte në kaos të plotë në atë kohë.

Prandaj, për shak të mungesës së provave, sa i përket pronësisë së gjësendeve të marra nga **G. M.** dhe **S. M.** dhe poashtu sa i përket kohës së pacaktuar kur gjedet janë marrë nga dyqani, Trupi gjykues konsideron se kushtet për të shpallur **G. M.** dhe **S. M.** fajtor për dëmtim të pronës së luajtshme, nën nenin 260 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, nuk janë përmbushur.

3. Provat lidhur me kanosjen ndaj personave zyrtarë nga G. M.

Nga dëshmitë e dy Palëve të dëmtuara, policëve **A. D.** dhe **A. J.**, dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, policëve **F. G.**, **F. R.** dhe **Xh. J.**, Trupi gjykues konsideron se, më 08 maj 2008, rreth orës 14:00, **G. M.** ka pasur sjellje kërcënuese ndaj dy policëve në detyrë, **A. D.** dhe **A. J.**, dhe prandaj, u ka shkaktuar shqetësim.

Sjellja kërcënuese e **G. M.** ndaj policëve **A. D.** dhe **A. J.** është vërtetuar përmes elementeve mbështetëse. Së pari, Trupi gjykues ka gjetur se **G. M.** ka qenë nën presion në ditën kritike pasi ishte udhëzuar të merrte pronën e tij nga dyqani, dhe, gjatë kohës sa ishte duke i larguar disa gjësende, ishte ndaluar nga policët. Në **intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës**, më 08 maj 2008, **G. M. ka deklaruar** se i kishte rezistuar policëve, dhe se nuk ka dashur të ndalojë punën. **G. M.** poashtu ka deklaruar se i kishte thënë policëve se nëse dikush e godet, më vonë do të përballet me pasojat. Poashtu **S. M.** ka dëshmuar në **intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës**, më 08 maj 2008, se **G. M.** nuk i kishte respektuar urdhrat e policëve.

Më tutje, sipas **Raportit** të policëve **A. D.** dhe **A. J.**, 08 maj 2008, dhe poashtu dëshmime të tyre në seancën dëgjimore të shqyrtimit kryesor më 28 dhjetor 2010, **G. M.** kishte fyer policët. Kjo rrjedh nga deklaratat e policëve se kur këta kishin arritur në vendin e ngjarjes kanë kërkuar nga **G. M.** të ndalojë punën e tij në dyqan. **G. M.** mori një teslicë në dorën e tij të djathtë dhe gojarisht ka kërcënuar rëndë se do të lëndojë policët, duke thënë fjalë të tilla si 'Do t'ua pres kokën'. Kjo u ka shkaktuar shqetësim të atillë policëve sa që ata kanë kërkuar mbështetje nga kolegët e tjerë. Si pasojë e kësaj kërkese, policët **B. B.**, **F. R.**, **Xh. J.** dhe **F. G.** kanë shkuar në vend të ngjarjes. Në këtë përfundim është arritur poashtu nga **Raporti** i policit **F. R.**, 08 maj 2008, dëshmia e **F. R.** dhënë në seancën dëgjimore të shqyrtimit kryesor më 28 dhjetor 2010, dëshmitë e **Xh. J.** dhe **F. G.** të dhëna në seancën dëgjimore të shqyrtimit kryesor më 28 dhjetor 2010. Më tej, **Raporti** i policit **F. R.**, 08 maj 2008, ka mbështetur dëshmitë e Palëve të dëmtuara **A. D.** dhe **A. J.**, se edhe pas arritjes së katër policëve, **G. M.** vazhdoi të fyejë policët. Gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit kryesor më 28 dhjetor 2010, **F. R.** ka mbështetur deklaratën e Palëve të dëmtuara se, derisa ka qenë i prangosur, **G. M.** ka kërcënuar policin **A. J.** se **A. J.** do të shohë se kush është **G. M.**, kur **A. J.** të gjendet në rroba civile.

Nga të gjitha këto elemente, Trupi gjykues konsideron se kushtet e paraqitura në nenin 161 paragrafi (4) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës janë përmbushur dhe prandaj shpalli **G. M.** fajtor për kanosje ndaj personit zyrtar.

4. Provat lidhur me kanosjen ndaj personit zyrtar nga S. M.

Sa i përket **S. M.**, nuk ka pasur bazë në provat e prezantuara para Trupit gjykues që do të tregonin se **S. M.** ka kryer veprën penale të paraparë në nenin 161 paragrafi (4) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Përkundrazi, gjatë shqyrtimit kryesor është dëshmuar nga të gjitha Palët e dëmtuara dhe dëshmitarët se **S. M.** ka qëndruar pasiv gjatë shkëmbimit verbal në mes të **G. M.** dhe policëve. Nga Palët e dëmtuara apo dëshmitarët nuk është treguar as për fyerje e as kërcënim nga **S. M.**. Për më tepër, është theksuar se **S. M.** ka shkuar vullnetarisht në stacionin policor ndërsa **G. M.** është dërguar atje i prangosur.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Trupi gjykues konsideron se nuk është dëshmuar se **S. M.** ka kryer veprën penale nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe prandaj është liruar nga kjo akuzë në pajtim me nenin 390 pika 3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

E. Përcaktimi i ndëshkimit

Siç është konkluduar më lart, veprimi i **G. M.** është cilësuar si kanosje ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Në pajtim me nenin 161 paragrafi (4) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës kryerësi i kësaj vepre penale duhet të ndëshkohet me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh deri në tre (3) vjet.

a. Sipas nenit 64 paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, gjatë caktimit të ndëshkimit Trupi gjykues duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese.

Trupi gjykues e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese situatën në të cilën **S. M.** ka kërcënuar policët **A. D.** dhe **A. J.**

Në veçanti, **G. M.** më 8 maj 2008 ka qenë duke i larguar gjësendet nga dyqani që deri në atë kohë e ka pasur në shfrytëzim për aktivitetin e tij të biznesit privat. Nuk ka pasur prova të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor se të drejtat e tij për të shfrytëzuar dyqanin për aktivitetin e tij të biznesit privat janë kontestuar. **G. M.** kishte nënshkruar Marrëveshjen, numër 184, 11 tetor 2004, për marrjen me qira të hapësirës me ndërmarrjen ‘**T.**’ në emër të nipit të tij **D. M.** Neni 2 i Marrëveshjes thotë se qiramarrësi kishte investuar mjete të konsiderueshme materiale në riparimin e dyqanit. Më tej, neni 4 i Marrëveshjes thotë se në rast të privatizimit të ndërmarrjes ‘**T.**’, qiramarrësi do të merr orën e rrymës dhe atë të ujit, dhe dyert e dyqanit. Pala e dëmtuar **M. B.**, ish-menaxher i ndërmarrjes ‘**T.**’, në seancën dëgjimore të shqyrtimit kryesor më 29 dhjetor 2010, ka konfirmuar se rreth kohës kur ka ndodhur incidenti ai e kishte udhëzuar **G. M.** të marrë investimet e tij nga dyqani. Siç pasoi nga dëshmitë e dëshmitarëve, në atë kohë tregu ishte duke u rrënuar dhe tregu ishte në një situatë mbase të çorganizuar.

Prandaj, kur në këto rrethana policët **A. D.** dhe **A. J.** kërkuan nga **G. M.** të ndalojë largimin e gjësendeve, është krijuar një situatë mbase konfuze për **G. M.** Specifikisht, sepse ai paraprakisht ishte udhëzuar që të marrë gjësendet nga dyqani. Për më tepër, kjo ka ndodhur nën rrethana kur ka ekzistuar rreziku që investimet e bëra në dyqan mund të plaçkiteshin, meqë tregu rrënohej, dhe **G. M.** mundohej të mbronte investimet e tij të pretenduara.

Më tej, Trupi gjykues poashtu ka vlerësuar se edhe pse **G. M.** i është kërcënuar policëve, ai pastaj i është dorëzuar policisë.

Bazuar në këto rrethana Trupi gjykues ka vendosur që ndaj **G. M.** të caktohet ndëshkimi minimal prej tre (3) muajsh burgim. Dhe, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, Trupi gjykues ka zëvendësuar këtë ndëshkim me gjobë prej 80 EUR, në pajtim me nenin 38 paragrafi (3) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

b. Sipas nenit 64 paragraph (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, gjatë përcaktimit të ndëshkimit për veprën penale, Trupi gjykues mori parasysh qëllimin e ndëshkimit.

Trupi gjykues ka vlerësuar se përmes ndëshkimit të caktuar, do të arrihen të dyja, edhe qëllimi i parandalimit individual dhe edhe qëllimi i parandalimit të përgjithshëm.

G. M. ka kërcënuar policët **A. D.** dhe **A. J.** si përgjigje ndaj kërkesës së tyre për të ndaluar marrjen e gjësendeve, që, në rrethana të veçanta, ishte konfuze. Në veçanti, meqë **G. M.** ishte i bindur që ka të drejtë të marrë gjësendet, pasi poashtu ishte udhëzuar kësisoji nga **M. B.** Sidoqoftë, Trupi gjykues thekson se edhe në rrethana të tilla policët nuk duhet të kërcënohen, dhe palët duhet të menaxhojnë situatën në mënyrë të qetë. Policët kryejnë një shërbim të rëndësishëm publik, duke garantuar rendin dhe sigurinë publike, dhe poashtu kanë detyrë të mbrojnë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë individëve dhe të parandalojnë rreziqet që i kanosen publikut. Prandaj, ndëshkimi i caktuar do të dekurajojë **G. M.** nga kryerja e veprave të tilla penale në të ardhmen, dhe poashtu të ngrisë vetëdijen lidhur me rëndësinë e funksioneve të policisë dhe që kërcënimet ndaj policëve do të ndëshkohen në mënyrë përkatëse.

F. Shpenzimet

Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga Trupi gjykues kur të sigurohen të dhënat e tilla në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Meqë Trupi gjykues e ka shpallur të akuzuarin **G. M.** fajtor për kanosje ndaj personit zyrtar, nën nenin 161 paragrafi (4) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, **G. M.**, në pajtim me nenin 102 paragrafi (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, do të kompenzojë shpenzimet e procedurës penale lidhur me veprën penale të kanosjes ndaj personit zyrtar, përpos shpenzimeve të përkthimit.

Gjykata Komunale në Mitrovicë

P. no. 63/2010

Përgatitur në anglisht, gjuha zyrtare.

Proçesmabjtëse

Gjykatësja kryesuese

Zane Ratniece
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Caroline Charpentier
Gjykatëse e EULEX-it

Mjeti ligjor:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Komunale në Mitrovicë Kolegjit prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda tetë ditëve nga data e dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 473 paragrafi (3) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.